



Ambasciata d'Italia
Tirana



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL



DEKLARATË E GRAVE DHE VAJZAVE NGA KOMUNITETET RURALE TË SHQIPËRISË

Ne, gratë dhe vajzat nga zonat rurale të Shqipërisë, jemi forca lëvizëse që mban gjallë komunitetet dhe ekonominë lokale.

Ne vijmë nga çdo cep i vendit: nga Kopliku, Shkodra, Vau i Dejës, Dibra, Bulqiza, Elbasani, Kolonja dhe Tirana.

Ne i përkasim brezave të ndryshëm, familjeve të mëdha dhe të reja. Ne sigurojmë ushqim për vendin, mbështesim ekonominë familjare dhe kontribuojmë çdo ditë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale.

Megjithatë, kontributi ynë shpesh mbetet i padukshëm, i nënvlerësuar dhe pa mbështetjen e duhur. Edhe pse jemi shtylla e bujqësisë dhe zhvillimit rural, ne zotërojmë vetëm 11% të tokës bujqësore në Shqipëri.¹ Në shumë raste, jemi bashkëpronare brenda familjes, por emrat tanë mungojnë në certifikatat e pronësisë. Kjo na mohon të drejtat tona, na kufizon aksesin në shërbime dhe mbështetje financiare, si dhe zhvillimin tonë si aktore ekonomike. Kjo cenon mirëqenien, sigurinë dhe aftësinë tonë për t'u përballur me krizat në një kohë sfiduese si e tashmja.

Ne nuk po kërkojmë favorizim. Ne kërkojmë të drejta të barabarta për pronësinë mbi tokën, si bazë për dinjitet, mundësi dhe progres të barabartë. Eliminimi i pengesave që na përjashtojnë nga të drejtat e pronësisë është thelbësor për të krijuar mekanizma që na mundësojnë të veprojmë dhe të vendosim për jetën tonë dhe për të ardhmen e komuniteteve tona.

Ne u bëjmë thirrje autoriteteve qendrore dhe vendore që:

- Të sigurojnë barazinë gjinore në pronësinë, menaxhimin dhe vendimmarrjen mbi tokën, si dhe të garantojnë mbrojtje sociale dhe ligjore për partneret/bashkëshortet e angazhuara në aktivitete bujqësore, përmes ndryshimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor dhe politik që rregullon bujqësinë, zhvillimin rural dhe pronën familjare, duke përfshirë Ligjin nr. 9817/2007, nr. 8337/1998, Kodin Civil dhe Kodin e Familjes.
- Të mbështesin zbatimin e kuadrit kombëtar politik dhe legjislativ për garantimin e barazisë gjinore, sikurse janë Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Ligji

¹ FAO dhe UN-Women. 2025. *Monitorimi dhe raportimi i barazisë gjinore në pronësinë e tokës në Shqipëri – Fuqizimi i grave rurale, politikat e tokës me përgjegjësi gjinore dhe zbatimi i treguesve të Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm 5.a.1 dhe 5.a.2. Raport Vlerësimi 2025.* Hartuar nga Merita H. Meçe dhe Eralda Çani, Budapest, <https://doi.org/10.4060/cd5891en>



Ambasciata d'Italia
Tirana



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL



për Barazinë Gjinore, me qëllim që të sigurohet harmonizimi me kuadrin politik dhe legjislativ të BE-së për barazinë gjinore dhe zbatimi efektiv i angazhimeve të përcaktuara në Kapitullin 11 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

- Të sigurojnë të dhëna të regjistrimit të tokës të ndara sipas gjinisë në Kadastrën Shtetërore, të cilat pasqyrojnë realisht të drejtat pronësore të grave, me qëllim mundësimin e politikëbërjes së bazuar në evidenca për arritjen e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 5.
- Të krijojnë një kuadër monitorimi dhe raportimi për barazinë gjinore në pronësinë e tokës, duke siguruar që INSTAT të integrojë një modul të dedikuar për aksesin dhe kontrollin e grave mbi tokën në regjistrimet e ardhshme dhe anketat vjetore; si dhe që shteti shqiptar të monitorojë dhe raportojë përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Të bëjnë titujt e përbashkët të pronësisë një kriter të detyrueshëm ose favorizues për të përfituar nga subvencionet, skemat financiare dhe programet e zhvillimit rural.
- Të ofrojnë këshillim ligjor, informim dhe mbështetje të vazhdueshme për gratë rurale në lidhje me të drejtat pronësore dhe aksesin në burime të tjera prodhuese.
- Të hartojnë masa të dedikuara buxhetore për mbështetjen e fermave dhe sipërmarrjet e drejtuara nga gratë.
- Të garantojnë shërbime publike funksionale, transport, kujdes shëndetësor dhe arsim cilësor, që u mundësojnë grave dhe familjeve të tyre një jetë dinjitoze në zonat rurale.
- Të përfshijnë gratë rurale jo vetëm si përfituese, por edhe si vendimmarrëse që ndikojnë në hartimin e politikave dhe programeve të zhvillimit rural.

Ne kërkojmë ndërmarrjen e masave konkrete tani. Një e ardhme e drejtë dhe e qëndrueshme për zonat rurale në Shqipëri nuk mund të ndërtohet nëse grave u mohohet e drejtat mbi pronësinë e tokës. Kontributi ynë është real, prania jonë është e vazhdueshme dhe potenciali ynë është i padiskutueshëm. Ne qëndrojmë të bashkuara, të vendosura për të ndërtuar të ardhmen që meritojmë.

